



Pranuar / Dorezuar Punijeno/Protalato Received/Delivery	16.04	2021	9	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinitca Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIP/STK	1839/2021		1/4	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.124/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Arditë Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.124/2021 të datës 05.03.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga "Shaban Polluzha", Nr. 223 në Drenasit, kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020, respektivisht kundër organit të punësimit-Ministria e Punëve të Brendshme/Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve të punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 16.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa A.nr.124/2021 e datës 05.03.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. **ANULOHET** Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 09.02.2021 për ankuesin.
- III. **DETYROHET** Udhëheqësi i Drejtpërdrejtë i ankuesit respektivisht Udhëheqësi i Sektorit të Sigurisë së Teknologjisë Informative në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit/MPB, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- IV. **OBLIGOHET** Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit, që të ndër marr veprimet që zbatimi i këtij vendimi të bëhet në si pikën III.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit në pozitën “Administrator i Lartë i TI-së për Rrjetin Mikrovalor” sipas Akt Emërimit të datës 03.10.2016, Udhëheqësi i Drejtpërdrejtë i ankuesit respektivisht Udhëheqësi i Sektorit të Sigurisë së Teknologjisë Informative në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit/MPB më datë 09.02.2021 ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen duke e vlerësuar me notën e përgjithshme mjaftueshëm (2.2).

Ankuesi, kundër vlerësimit të rezultateve në punës për vitin 2020, më datë 05.03.2021 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot: 1008/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore që me rastin e vlerësimit të rezultateve në punës nuk kemi pasur takim për diskutim për të vlerësuar arritjen e objektivave.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konform dispozitave ligjore në fuqi me datën 09.03.2021 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Me datë 15.03.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me numër protokolli 1008/2021 të datës 05.03.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 09.02.2021; E-mailin e datës 02.03.2021 dhe 25.02.2021 nga ankuesi; Akt Emërimit të datës 03.10.2016; Përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit; Vlerësimin nëpërmjet sistemit SIMBNJ; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 25.12.2018, 21.01.2020 dhe Përgjigjen në ankesë e datës 15.03.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të varashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e bazuar, *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se me rastin e vlerësimit të rezultateve në punës nuk kemi pasur takim për diskutim për të vlerësuar arritjen e objektivave, ka konstatuar që me nenin 43 paragrafin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrat e Publikë, shprehimisht është përcaktuar që *“Raporti i jepet punonjësit dhe ai diskutohet në një intervistë me të. Pas intervistës, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë miraton raportin përfundimtar të vlerësimit”*, andaj në këtë komunikim po ashtu edhe në bazë të provave të lëndës, konstatohet që udhëheqësi i drejtpërdrejt e ankuesit nuk ka ndjekur hapat procedural sipas nenit të lartcekur, sepse përveç që ka hartuar një raport vlerësimi, në asnjë dëshmi ky raport nuk i është dorëzuar paraprakisht ankuesit për të shikuar, apo në asnjë dëshmi nuk mund të vërtetohet që ankuesi është ftuar në intervistë nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë për të diskutuar lidhur me vlerësimin dhe për të diskutuar lidhur me arritjen e objektivave të planifikuar, në këtë rast sipas vlerësimit të Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, udhëheqësi i drejtpërdrejt e ankuesit ka bërë shkelje procedurale të nenit 43 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrat e Publikë nenit 8 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1, 1.2 dhe 1.3, paragrafit 2

dhe 4 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punës të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në provat e lëndës, konstaton se në bazë të provave të lëndës, ankuesi gjatë periudhës së vlerësimit nuk ka pasur asnjë lloj vërejtje në punën e tij në aspektin profesional.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të provave të lëndës, ka konstatuar që udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit respektivisht Udhëheqësi i Sektorit të Sigurisë së Teknologjisë Informative në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit/MPB, duke marr parasysh të lartcekurat, dhe po ashtu duke marr parasysh faktin që realizimi i punës së sektorit respektivisht i udhëheqësit varet edhe nga vartësit e tij, detyrohet të bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës për ankuesin në pajtim me përshkrimin e detyrave të punës së tij dhe këtë ta bëjë në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar dhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.124/2021, datë 16/04/2021

Avdyl BEKTESHI

per: 
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit;
- Udhëheqësi i Sektorit të Sigurisë së Teknologjisë Informative në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit/MPB;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.